

AKT THEMELIMI
DHE
STATUTI I SHOQËRISË
HONEST SHPK

Sot, më 05.03.2021, të nënshkruarit:

- i. Z. Ismail Serana, shtetas shqiptar, lindur më 21.04.1965 në Gllavë, mbajtës i pashaportës me nr. G50421111D, dhe*
- ii. Z. Ilir Bilibashi, shtetas shqiptar, lindur më 26.12.1982 në Nepravishtë, mbajtës i pashaportës me nr. I21226142L,*

në cilesinë e ortakëve, me vullnet të lire dhe të plotë, nëpërmjet këtij akti themelojnë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë dhe këtë akt.

Neni 1

Emërtimi

Shoqëria emërtohet **HONEST SHPK** (në vijim referuar si “**Shoqëria**”).

Neni 2

Forma Juridike

HONEST SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe organizuar në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare, të ndryshuar dhe në përputhje me këtë akt.

Neni 3

Selia

- 3.1.** Selia e Shoqërisë do të jetë në adresën: *Rruga “Tish Daija”, Kompleksi Kika 2, Godina 9, Njësia 1, Tiranë, Shqipëri.*
- 3.2.** Administratori/ët mund të hapë/in dhe/ose mbyllë/in degë dhe/ose dyqane dhe/ose magazina, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.

Neni 4

Kohëzgjatja

- 4.1. Shoqëria ushtron aktivitetin e saj për një afat të pacaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar, të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit.
- 4.2. Prishja dhe likuidimi i Shoqërisë do të përcaktohen me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, në përputhje me dispozitat e këtij Statuti dhe legjislacionit në fuqi.

Neni 5

Objekti i Veprimtarisë

- 5.1. Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë, por nuk do të kufizohet në:
 - a. shitje të produkteve kozmetike;
 - b. shitje të detergjentëve;
 - c. import dhe eksport të produkteve të ndryshme.
- 5.2. Pavarësisht sa më sipër, Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet të nevojshëm apo të dobishëm të lejuar nga ligji për realizimin e objektit të saj të veprimtarisë.

Neni 6

Kapitali

- 6.1. Kapitali themeltar i Shoqërisë është 6,250,000 (6 million e dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë.
- 6.2. Kapitali i Shoqërisë përbëhet nga 2 (dy) kuota, njëra me vlerë nominale 3,750,000 (tre million e shtatëqind e pesëdhjetë mijë) lekë dhe tjetrën me vlerë nominale prej 2,500,000 (dy million e pesëqind mijë) lekë.

Neni 7

Ortakët

- 7.1. Ortakët e Shoqërisë janë si më poshtë:
 - Z. Ismail Serana, shtetas shqiptar, lindur më 21.04.1965 në Gllavë, mbajtës i pashaportës me nr. G50421111D, zotërues i 1 (një) kuote të barabartë me 60 (gjashtedhjetë përqind) të kapitalit, në vlerën 3,750,000 (tre million e shtatëqind e pesëdhjetë mijë) lekë.
 - Z. Ilir Bilibashi, shtetas shqiptar, lindur më 26.12.1982 në Nepravishtë, mbajtës i pashaportës me nr. I21226142L, zotërues i 1 (një) kuote të barabartë me 40 (dyzet përqind) të kapitalit, në vlerën 2,500,000 (dy million e pesëqind mijë) lekë.

- 7.2. Kuotat janë të transferueshme dhe mund të transferohen në çdo kohë në përputhje me kushtet dhe afatet që parashikohen në ligjin shqiptar dhe këtë statut. Përgjegjësia e ortakëve shtrihet deri në vlerën e kontributit të tyre në kapitalin e Shoqërisë.

Neni 8

Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit

- 8.1. Kapitali i Shoqërisë mund të zmadhohet në çdo kohë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.
- 8.2. Shoqëria në çdo kohë mund të zvogëlojë kapitalin me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve. Në çdo rast, kapitali nuk mund të zvogëlohet nën minimumin e 100 (njëqind) lekë, që është minimumi i vlerës së kërkuar nga ligji.

Neni 9

Transferimi i Kuotës

Ortakët mund të vendosë në çdo kohë për pjesëtimin dhe transferimin e kuotës përmes shitjes, dhurimit, apo ndonjë mënyre tjetër të parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

Neni 10

Vendimmarrja

- 10.1. Organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve.
- 10.2. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është përgjegjës, ndër të tjera, për vendime në lidhje me çështjet e mëposhtme:
- i. përcaktimin e politikave të biznesit të Shoqërisë;
 - ii. ndryshimin, modifikimin, plotësimin e statutit;
 - iii. emërimin dhe shkarkimin e administratorëve, vendosjen dhe ndarjen e kompetencave të tyre, si dhe shpërblimin përkatës;
 - iv. zmadhimin dhe/ose zvogëlimin e kapitalit;
 - v. transferimin e kuotave;
 - vi. shpërndarjen e fitimeve;
 - vii. riorganizimin, prishjen dhe/ose likuidimin e Shoqërisë; dhe
 - viii. çdo çështje tjetër të parashikuar nga legjislacioni i zbatueshëm dhe ky Statut.

Neni 11

Regjistri i Vendimeve

- 11.1.** Të gjitha vendimet e marra nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve regjistrohen në Regjistrin e Vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet të regjistrohen në veçanti, vendimet e mëposhtme:
- i. miratimi i pasqyrave financiare dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - ii. shpërndarja e fitimeve dhe humbjeve;
 - iii. zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit themeltar;
 - iv. vendime në lidhje me investimet;
 - v. riorganizimi dhe prishja e Shoqërisë.
- 11.2.** Lista e mësipërme nuk është shteruese. Dhe vendimet të cilat nuk regjistrohen në Regjistrin e Vendimeve, do të konsiderohen të pavlefshme.

Neni 12

Administrimi

- 12.1.** Shoqëria do të administrohet nga dy administratorë.
- 12.2.** Administratorët e parë të Shoqërisë janë:
- Z. Ismail Serana, shtetas shqiptar, lindur më 21.04.1965 në Gllavë, mbajtës i pasaportës me nr. G50421111D, dhe
 - Z. Ilir Bilibashi, shtetas shqiptar, lindur më 26.12.1982 në Nepravishtë, mbajtës i pasaportës me nr. I21226142L
- 12.3.** Administratori/ët do të emërohen me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve dhe mund të shkarkohen në çdo kohë me një vendim të njëjtë.
- 12.4.** Kompetencat specifike të secilit Administrator do të vendosen me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve dhe mund të ndryshohen në të njëjtën mënyre.
- 12.5.** Administratorët janë persona fizikë, pa ndonjë kufizim në lidhje me shtetësinë. Kohëzgjatja e mandatit të Administratorit/ëve do të vendoset në momentin e emërimit, por në çdo rast nuk mund të tejkalojë afatin 5 (pesë) vjeçar. Pavarësisht këtij kufizimi, kohëzgjatja e mandatit të administratorit mund të ripërtërihet me anë të vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.

Neni 13

Kompetencat e Administratorit

- 13.1.** Administratorët janë përgjegjës për administrimin e Shoqërisë dhe përfaqësojnë Shoqërinë me palët e treta, në përputhje me dispozitat e këtij Statuti dhe legjislacionin e zbatueshëm.

- 13.2.** Kompetencat dhe detyrat e administratorit në lidhje me administrimin dhe mbikëqyrjen e aktivitetit të Shoqërisë përfshijnë, por nuk do të kufizohen në:
- i. zbatimin e politikave të biznesit të Shoqërisë dhe vendimet të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve;
 - ii. sigurimin e përputhshmërisë me legjislacionin dhe standardet e kontabilitetit nga Shoqëria;
 - iii. kryerjen e të gjitha veprimeve lidhur me administrimin e veprimtarisë së Shoqërisë;
 - iv. sigurimin e mbajtjes së rregullt të dokumenteve financiare dhe kontabël të Shoqërisë;
 - v. përfaqësimin e Shoqërisë me palët e treta;
 - vi. kryerjen e të gjitha regjistrimeve dhe publikimeve të detyrueshme në lidhje me Shoqërinë, që kërkohen sipas legjislacionit në fuqi;
 - viii. kryerjen e detyrave të tjera të parashikuara në legjislacionin e zbatueshëm dhe në këtë Statut.
- 13.3.** Administratorët mund të ushtrojnë të gjitha kompetencat dhe veprimet, me përjashtim të atyre që me ligj dhe nga ky Statut janë të rezervuara për Asamblenë e Përgjithshme të Ortakëve.
- 13.4.** Kompetencat e secilit Administrator mund të vendosen me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve dhe mund të modifikohen në të njëjtën mënyre.
- 13.5.** Për qëllimet e kryerjes së procedurave për regjistrimin e Shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe çdo autoriteti tjetër në Shqipëri, si edhe për hapjen e llogarisë bankare të Shoqërisë, çdo akt/vendim/autorizim i Administratorëve do të jetë i vlefshëm nëse nënshkruhet të paktën nga të 2 (dy) Administratorët.
- 13.6.** Të gjitha vendimet e tjera të Administratorëve duhet të nënshkruhen nga 2 (dy) Administratorë në mënyrë që të jenë të vlefshme dhe angazhojnë Shoqërinë.
- 13.7.** Administratorët mund të delegojë një pjesë ose të gjitha kompetencat e tij tek persona të tjerë.

Neni 14

Audituesi ligjor

Nëse kërkohet me ligj ose miratohet nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve, kontrolli i pasqyrave financiare dhe të dhënave kontabël të Shoqërisë do t'u besohet një ose me shumë ekspertëve kontabël të autorizuar.

Neni 15

Viti Financiar dhe Pasqyrat Financiare

- 15.1.** Viti ushtrimor fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të çdo viti.
- 15.2.** Viti i parë ushtrimor fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar dhe përfundon më 31 dhjetor 2021.

- 15.3. Pasqyrat financiare vjetore, inventari, raporti i Administratorit dhe audituesit ligjor të autorizuar, nëse ka një të tillë, miratohen nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve në përputhje me ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar.
- 15.4. Miratimi i dokumenteve lidhur me pasqyrat financiare do të kryhet çdo vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga përfundimi i vitit ushtrimor.

Neni 16

Prishja dhe Likuidimi i Shoqërisë

- 16.1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve mund të vendosë për prishjen e Shoqërisë. Prishja e Shoqërisë do të shoqërohet me procedurën e likuidimit të saj.
- 16.2. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve emëron një ose më shumë likuidues, duke përcaktuar tagrat e tyre në përputhje me objektivat.
- 16.3. Shoqëria vazhdon të ekzistojë si person juridik për nevoja të likuidimit deri në përfundim të këtij procesi. Gjate kësaj procedure, togfjalëshi “në likuidim e sipër” duhet të vihet pas emrit të Shoqërisë.

Neni 17

Ligji i Zbatueshëm dhe Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve


- 17.1. Ky akt bazohet ne legjislacionin shqiptar dhe interpretimi, vlefshmëria dhe zbatimi i tij, duhet të kryhen në përputhje me dispozitat e legjislacionit shqiptar.
- Dispozitat e ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar do të zbatohet për çështjet që nuk rregullohen nga ky dokument.
- 17.2. Mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e këtij akti do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Tiranës.

Ky Statut përpilohet në 2 (dy) kopje në anglisht.

PËR ORTAKËT E VETËM


Z. Ismail Serana

[nënshkrim]



Z. Ilir Bilibashi

[nënshkrim]



Vendimi i Bordit te Drejtoreve te Shoqerise Honest sh.p.k.

Sot me date 05.03.2021, eshte mbajtur mbledhja e Bordit te Drejtoreve te shoqerise Honest sh.p.k., per te diskutuar dhe vendosur per rendin e dites si vijon:

Rendi i dites:

1. Themelimi i nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar ne Republiken e Shqiperise.

Drejtoret e meposhtem jane te pranishem ne mbledhje:

- *Z. Ismail Serana, shtetas shqiptar, lindur më 21.04.1965 në Gllavë, mbajtës i pashaportës me nr. G50421111D, ne cilesine e Kryetarit te Bordit, dhe*
- *Z. Ilir Bilibashi, shtetas shqiptar, lindur më 26.12.1982 në Nepravishtë, mbajtës i pashaportës me nr. I21226142L, ne cilesine e Anetarit te Bordit.*

Pasi analizoi dhe diskutoi rreth pikes se pare te rendit te dites Bordit i Drejtoreve unanimisht:

VENDOSI:

1. Te krijoje nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar ne Republiken e Shqiperise, te zoteruar teresisht nga ortaket Ismail Serana dhe Ilir Bilibashi.

- Shoqeria do emertohet HONEST SH.P.K.
- Selia e Shoqerise do jete ne adresen: Rruga "Tish Daija", Kompleksi Kika 2, Godina 9, Njësia 1, Tiranë, Shqipëri.
- Administrator i pare i Shoqerise do te jete:
 - *Z. Ismail Serana, shtetas shqiptar, lindur më 21.04.1965 në Gllavë, mbajtës i pashaportës me nr. G50421111D, ne cilesine e Kryetarit te Keshillit te Administrimit, dhe*
administrator i dyte do te jete:
 - *Z. Ilir Bilibashi, shtetas shqiptar, lindur më 26.12.1982 në Nepravishtë, mbajtës i pashaportës me nr. I21226142L, ne cilesine e Anetarit te Keshillit te Administrimi.*
- Kapitali themeltar i HONEST SHPK do jete ne vleren 6,250,000 (6 million e dyqind e pesedhje mije) Leke.

- Objekti i aktivitetit te HONEST SHPK eshte:
 - shitja e detergjenteve te ndryshme;
 - shitje e produkteve te ndryshme kozmetike;
 - import dhe eksport te produkteve te ndryshme.

Per HONEST SH.P.K.

Z. Ismail Serana

Kryetar i Bordit

Ismail Serana
[nenshkrimi]

Z. Ilir Bilibashi

Anetar i Bordit

ILIR BILIBASHI
[nenshkrimi]